

Në bazë të nenit 48 paragrafi (5) të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 3/25, 74/25 dhe 111/26), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE
për standardet dhe normat për akreditimin e institucionit
të arsimit për mjeshtër

Neni 1

Me këtë rregullore vërtetohen standardet dhe normat që duhet t'i plotësojë institucioni për t'u akredituar për realizimin e arsimit për mjeshtër në arsimin pas të mesëm.

Neni 2

Për akreditimin e institucionit për arsimin e mjeshtëreve në arsimin pas të mesëm (në tekstin e mëtejshëm: institucioni), është e nevojshme që institucioni të ketë të siguruara plane mësimore, programe mësimore dhe programe të provimeve, të përcaktuara nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me të cilat do të realizohet arsimi për mjeshtër për kualifikimin përkatës.

Neni 3

Institucioni duhet të disponojë me klasë për zhvillimin e mësimi teorik me së paku 1,7 m² hapësirë për çdo nxënës.

Hapësira duhet të mundësojë akomodimin e përshtatshëm të numrit të planifikuar të nxënësve, duke siguruar qarkullim të lirë dhe kushte për zhvillimin e pandërprerë të procesit mësimor.

Vendosja e bankave, karrigeve dhe pajisjeve të tjera duhet të mundësojë realizimin e formave të ndryshme të punës mësimore.

Rrugët e lëvizjes duhet të jenë të pandërprerë me hapësirë të siguruar për kthim dhe kalim.

Neni 4

Institucioni duhet të disponojë me klasë për mësim praktik, të pajisur me mjete dhe materiale didaktike, në përputhje me programet mësimore dhe standardet e normat për hapësirën dhe pajisjet.

Nëse institucioni nuk disponon me pajisjet dhe hapësirën e përcaktuar me standardet dhe norma për hapësirën dhe pajisjet, mund të lidhë marrëveshje me punëdhënësin i cili i plotëson standardet dhe normat për hapësirën dhe pajisjet, për shfrytëzimin e hapësirës përkatëse (dyqan artizanal, punëtori ose hapësirë tjetër përkatëse) për realizimin e mësimi praktik.

Neni 5

Institucioni duhet të disponojë me mjete financiare për realizimin e arsimit për mjeshtër dhe për realizimin e provimit të mjeshtërisë.

Për përmbushjen e kushtit nga paragrafi (1) i këtij neni, institucioni dorëzon deklaratë të nënshkruar për sigurimin e mjeteve financiare.

Neni 6

Institucioni disponon me dokumentacionin dhe aktet përkatëse me të cilat sigurohet përmbushja e kushteve për siguri dhe shëndet në punë, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut, dëshmi për kontrollet e kryera të instalimeve elektrike dhe kundër zjarrit, pajisje mbrojtëse të siguruara dhe dokumentacion tjetër në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 7

Mësimin në institucion e reagon kuadri mësimor i cili i plotëson kushtet në përputhje me normat për kuadrin mësimor të përcaktuara në programet mësimore për arsimin për mjeshtër.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e miratimit të saj.

Nr.13-9407/1

15.07.2026

Shkup

**Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска, d.v.**